

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2025

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Data: 15/07/2025

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ☒ ose

“EUROCAR RENTALS” sh.p.k

L71607505F

Adresa: Durres, Autostrada Durres-Tirane, Km 6

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedure e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar, Kontratë.

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: **REF-46091-04-25-2025**

Loti 1: REF-46104-04-25-2025

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Marrje mjetes rrugore me qira për policinë e shtetit”, me **REF-46091-04-25-2025, me fond limit total** 450,695,808 (Katërqind e pesëdhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tetë) Lekë, **pa TVSH** ose 4,564,932.73 (Katër milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e tre) **Euro pa TVSH, ndarë në dy lote:**

Loti 1: “Marrje autovetura SEDAN me qira për policinë e shtetit”, me fond limit **222,895,180.80** (Dyqind e njëzet e dy milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë pikë

tetëdhjetë) **Lekë pa TVSH** ose **2,257,623.63** (Dy milion e dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e njëzet e tre pikë gjashtëdhjetë e tre) **Euro pa TVSH**.

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 23.06.2025

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit

Buletini Nr.33, date 30 Qershor 2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “ALBANIA MOTOR COMPANY” sh.p.k

K41829010I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera e ofruar: 171,360,000 (njëqind e shtatëdhjetë e një milion e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “EUROCAR RENTALS” sh.p.k

L71607505F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: 198,720,000 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “PORSCHE LEASING” sh.p.k

L31623006N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: 199,408,320 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e katërqind e tetë mijë e treqind e njëzetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. “TIRANA AUTO” sh.p.k

K82318007Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar: 204,376,000 (dyqind e katër milion e treqind shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “ALBANIA MOTOR COMPANY” sh.p.k

K41829010I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet e skualifikimit:

- Operatori ekonomik “Albania Motor Company” sh.p.k. (AMC), nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim në lidhje me kapacitetin teknik të kërkuar sipas pikës 2.3.1 dhe 2.3.7 të Seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” për këto arsye:

I) Nuk plotëson pikën 2.3.1 për shërbimet e ngjashme në tre vitet e fundit të aktivitetit.

Për plotësimin e këtij kriteri, OE “Albania Motor Company” sh.p.k., ka paraqitur vërtetimin me Nr.682/1 dt 27.05.2025 nga Drejtoria e Pergjithshme e Policise, referuar të cilit rezulton se operatori ekonomik ka realizuar ne formën e BOE (AMC 49% +Antigone Rentals 51%) vlerën prej 116,619,954 lekë pa tvsh për kontraën me objekt “Marrje me qera operationale te autoveturave ne sherbim te Policise te Shtetit”. Referuar perqindjes së pjesëmarrjes në BOE, “Albania Motor Company” sh.p.k. ka realizuar shërbime të ngjashme sipas kësaj kontrate në masën 49% x 116,619,954= 57,143,777 lekë me tvsh dhe **47,619,814 lekë pa tvsh**, vlerë e cila nuk plotëson vlerën e kërkuar sipas kërkesës, e cila kërkohet jo më pak se **40% e Fondit Limit** ose **89,158,072 leke pa TVSH**.

Gjithashtu, OE “Albania Motor Company” sh.p.k. ka paraqitur 65 fatura tatimore shitje të automjeteve të tipit “Ford Focus” me vlere totale 62,093,750 lekë pa TVSH. Këto fatura kane si objekt “shtiblerje automjetsh” të cilat nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit “shërbimi i dhënies me qera të automjeteve ose leasing operacional”. KVO argumenton se referuar

legjislacionit sipas Kodit Civil, shitblerja nuk mund të konsiderohet e ngjashme me qerane. Shtiblerja është një veprim juridik ku shitesit i humbet e drejta e sendit në favor të blerësit pasi ky i fundit paguan vlerën e plotë të sendit, ndërsa në rastin e qeradhënies pronësia i mbetet shitësit të shërbimit i cili ka detyrimin të mirëmbajtjes në mënyrë të vazhdueshme sendin kundrejt pagesës të një shume mujore nga blerësi i shërbimit. Gjithashtu edhe referuar këtij prokurimi objekti i kësaj kontrate “*dhënia me qera operationale e automjeteve*” nuk është absolutisht e ngjashme me “*shitblerjen e automjeteve*” pasi Autoriteti Porositës (Policia e Shtetit) ka vendosur si kusht që ofertuesi duhet të sigurojë mirëmbajtjen e vazhdueshme të automjeteve që Policia e Shtetit do të marrë me qera me qera, duke disponuar madje kapacitetet teknike të nevojshme (disponimi i një servisi për mirëmbajtjen dhe riparimet) për këtë qëllim. Pra shitblerja e automjeteve nga Albania Motor Company nuk është e ngjashme me objektin e prokurimit “shërbimi i dhënies me qera të automjeteve”.

Në konkluzion referuar shërbimeve të ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit rezultojnë se ofertuesi “Albania Motor Company” sh.p.k, nuk plotëson vlerën e kërkuar në dokumentat e tenderit për shërbimet e ngjashme për dhënie automjete me qera, pasi me dokumentacione e paraqitur vërtetohet realizimi i shërbimeve të ngjashme në vlerën 47,619,814 lekë pa TVSH, nga 89,158,072 leke pa TVSH (40% e Fondit Limit) të kërkuara në dokumentat e tenderit.

II) Nuk plotëson pikën 2.3.7, kapacitetet teknike për disponimin e një servisi për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve.

Referuar pikës 2.3.7 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim kërkohet:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, sipas specifikimeve teknike. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- *Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).*

Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i kontratës dhe të jetë e specifikuar adresa e ambientit.

- *Në rast se shërbimi i riparimit apo mirëmbajtjes së mjeteve do të kryhet përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, ofertuesi duhet të dorëzojë kontratën e bashkëpunimit, ku të jetë e specifikuar adresa e servisit dhe afati i kontratës.*

Argumentimi i Njesisë të Prokurimit: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Bazuar në specifikimet

teknike ku përfshihen kryerja e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve dhe kryerja e riparimeve jo-rutinë në rast nevojë ky kriter është në funksion të garantimit të cilësisë së shërbimit, sigurisë teknike të mjeteve, si dhe mosndërprerjes së punës operationale.

Arsyetimi i KVO.

Pra në bazë të kërkesës për kualifikim Autoriteti Kontraktor ka vendosur si kusht për kualifikim disponimin e një ambient servisi të automjeteve , disponim i cili vërtetohet në dy mënyra:

1. Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera të një servisi të riparimit të automjeteve.
2. Lidhja e një kontrate te vlefshme me një subjekt i cili disponon një servis të riparimit të automjeteve.

Konkretisht, OE “Albania Motor Company” sh.p.k, ka paraqitur kontratën Nr.1163 Rep, Date 27.05.2025, marrje me qera pasuri e paluajtshme qera truall 5000 m2 dhe ndertese 2160 m2 nga subjekti Safe Security Albania sh.p.k. Kontrata ne Nenin 2 përcakton se ambienti do të përdoret për servis dhe shitje automjeteve mirëpo dokumenti nuk ka te dhena nese ambjenti permban nje servis të automjeteve në pronësi të OE ”Albanian Motor Company”. KVO gjithashtu kontrollloi në regjistrin publik on-line të Qendrës Kombëtare të Biznesit nga ku rezultoi se:

- Subjekti që ka dhënë ambientin me qera, shoqëria ”Safe Security Albania” sh.p.k nuk disponon liçense per mirembajtje dhe riparim te automjeteve.
- Subjekti ofertues “Albania Motor Company” sh.p.k nuk disponon liçense te vlefshme per mirembajtje dhe riparim te automjeteve. Liçensa LN-5474-07-2018, rezulton se nuk është aktive dhe se i ka skaduar afati ne daten 09.07.2023. Pra, referuar dokumentacionit publik në QKB rezulton se ofertuesi nuk disponon servis automjeteve ne momentin e hapjes dhe vleresimit te ofertave.

Për këto arsye, referuar kërkesës për kualifikim në dokumentat e tenderit ku kërkohet shprehimisht që ofertuesi duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, sipas specifikimeve teknike, rezulton se OE “Albania Motor Company” sh.p.k, në momentin e hapjes dhe vlerësimit, nuk vërteton se disponon një servis për shërbimin dhe riparimin e automjeteve, sipas kushteve të përcaktuara në Dokumentat e Tenderit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “PORSCHÉ LEASING” sh.p.k

L31623006N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik "PORSCHE LEASING" sh.p.k, me NUIS L31623006N, referuar dokumentacionit ligjor të paraqitur në procedurë, nuk plotëson Kërkesat e Përgjithshme për Kualifikim, pasi nuk ka paraqitur informacionin e detyrueshëm që kërkohet në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit dokument ligjor përmbajta e të cilit është përcaktuar në VKM nr.285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Konkretisht operatori ekonomik "Porsche Leasing" sh.p.k, nuk ka plotësuar informacionin e kërkuar në Seksionin A: "Deklarata për Përmbylljen e Kriterëve të Përgjithshme", në lidhje me të dhënat e personave aksionarëve ose ortakëve të operatorit ekonomik ofertues, megjithëse rubrika përcakton qartë mënyrën e plotësimit:

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së,

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Referuar formularit të vetdeklarimit operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë informacion për "Personin / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik".

Porsche Leasing sh.p.k kishte detyrimin ligjor, si posedues i të dhënave personale dhe juridike të subjektit tregtar, të dorëzonte pranë Autoritetit Kontraktor që kryen prokurimin, të dhënat e plota të administratorëve, aksionerëve apo ortakëve në bazë të strukturës së ndërtimit të shoqërisë tregtare.

Në formularin e vetdeklarimit nuk është paraqitur informacioni i detyrueshëm mbi gjeneralitetet, numrat e identifikimit (nr/id ose nr/pasaporte) sipas shtetit të origjinës ku ata janë shtetas si dhe mungojnë të dhëna ku Autoriteti do të kryjë verifikimin e informacionit në lidhje me plotësimin e kriteret detyrues për skualifikim sipas nenit 76, pika 1 të LPP, Pikat a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;d) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;e) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;f) falsifikim;g) puna

e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Nisur nga specifika e operatorit ekonomik ofertues ku të gjithë ortakët dhe aksionarët nuk janë shtetas shqiptarë, KVO vlerëson se ofertuesi ka shmangur dhenien e informacionit të domosdoshëm për tu deklaruar nga ana e tij, duke shkelur detyrimin ligjor për plotësimin e rubrikës përkatëse të Formularit të Vetdeklarimit në fazën paraprake kualifikuese të procedurës së prokurimit.

Mbështetur në faktet dhe rrethanat e parashtruara më sipër, në kushtet kur:

1. Legjislacioni dhe rregullat e prokurimit detyrojnë ofertuesit që në këtë fazë të procedurës kanë detyrimin të dorëzojnë informacionin e kërkuar që do të shërbejë për verifikim në fazën e dytë të procedurës, të plotësimit të kushteve detyruese për skualifikim sipas nenit 76 të LPP, si dhe;
2. Referuar praktikës që ndjek Komisioni i Prokurimit Publik për raste të ngjashme (Vendimet e KPP Nr.1240/2024, Nr.385/2025, Nr.130/2025 Nr.121/2025) në vlerësimin e shkeljeve në plotësimin e informacioneve të kërkuara sipas Formularit Standart të Vetëdeklarimit në Dokumentat e Tenderit,

KVO vendos ta refuzojë ofertën e ofertesit Porsche Leasing në bazë të Nenit 80, pika 1 germa a) të LPP, pasi oferta nuk përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

* * *

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “TIRANA AUTO” sh.p.k
Emri i plotë i shoqërisë

K82318007Q
Numri i NIPT-it

Arsyet e skualifikimit:

Tirana Auto sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.7, kapacitetet teknike për disponimin e një servisi për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve.

Referuar pikës 2.3.7 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim kërkohet:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, gjatë gjithë kohëzgjatjes së

kontratës, sipas specifikimeve teknike. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i kontratës dhe të jetë e specifikuar adresa e ambientit.

Në rast se shërbimi i riparimit apo mirëmbajtjes së mjeteve do të kryhet përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, ofertuesi duhet të dorëzojë kontratën e bashkëpunimit, ku të jetë e specifikuar adresa e servisit dhe afati i kontratës.

Argumentimi i Njesisë të Prokurimit: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Bazuar në specifikimet teknike ku përfshihen kryerja e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve dhe kryerja e riparimeve jo-rutinë në rast nevojë ky kriter është në funksion të garantimit të cilësisë së shërbimit, sigurisë teknike të mjeteve, si dhe mosndërprerjes së punës operationale.

Referuar kërkesës për kualifikim Autoriteti Kontraktor ka vendosur si kusht për kualifikim disponimin e një ambient servisi të automjeteve objekt i kontratës në dy mënyra:

1. Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera të një servisi të riparimit të automjeteve.
2. Lidhja e një kontrate të vlefshme me një subjektin i cili disponon një servis të riparimit të automjeteve.

Konkretisht, OE “Tirana Auto” sh.p.k, ka paraqitur një vetedeklarim se disponon servis të specializuar për kryerjen e të gjitha defekteve teknike të mjeteve marrjen përsipër të shërbimeve të kërkuara shërbimet. Ky dokument nuk shoqërohet me asnjë nga dokumentet e kërkuara në pikën 2.3.7 që vërtetojnë pronësinë, marrjen me qera apo kontraktimin e një servisi automjetesh. KVO gjithashtu kontrollon në regjistrin publik on-line të Qendrës Kombëtare të Biznesit nga ku rezultoi se:

- OE ofertues “Tirana Auto” sh.p.k nuk disponon license të vlefshme për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, në momentin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

Për këto arsye referuar kërkesës për kualifikim në dokumentat e tenderit ku kërkohet shprehimisht që ofertuesi të disponojë servis për automjete në funksion të garantimit të cilësisë së shërbimit, sigurisë teknike të mjeteve, si dhe mosndërprerjes së punës operationale Tirana Auto sh.p.k, në

momentin e hapjes dhe vlerësimit, nuk vërteton se disponon një servis për shërbimin dhe riparimin e automjeteve, sipas kushteve të përcaktuara në Dokumentat e Tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik **“EUROCAR RENTALS” sh.p.k** me NIPT **L71607505F**, me adresë: Durrës, Autostrada Durrës-Tiranë, Km 6, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 198,720,000 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e shtatëqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të policisë së Shtetit, me adresë: Bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit që do t’iu njoftohet nga autoriteti kontraktor përfitues.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet siguri i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO X JO ☐

Nëse Po (Nr. __ Datë __ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)

Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 879/2025 Nr. 1641/7 prot., datë 10.07.2025